


## André Malraux: Një udhëtim në shekullin e 20-të

Amantia Kapo

"Shpresa" është fryt i vetë eksperiencës së shkrimtarit si udhëheqës i një skuadroni pilotësh republikanë gjatë angazhimit të tij në këtë luftë nga gushti 1936 deri në mars 1937. Narracioni i romanit "Shpresa" është fokusuar në palën republikane, duke përfshirë një shumëllojshmëri personazhesh, nëpërmjet të cilëve tregohet organizimi dhe ndërtimi i kampit republikan i përbërë nga të gjitha rrymat e majta të vendit (komunistët, anarkistët, socialistët...) dhe nga mbështetja e jashtme (Brigadat Ndërkombëtare, mbështetja sovjetike, e cila është taktike). Romani është ndarë në tri pjesë, të cilat rimojnë këtë reportazh luftime. Në pjesën e parë iluzioni lirik, përshkruan entuziazmin e republikanëve, të cilët mendojnë fillimisht se mund ta ndalojnë armikun falë guximit të tyre të çorganizuar dhe më tej mobilizimin e të gjitha rrymave politike në krijimin e një ushtrie të vërtetë. Në pjesën e dytë, Manzanaresi, ushtria republikane është duke u organizuar dhe arrin të marrë Madridin, duke sprapsur trupat nacionaliste. Fashistët rrethojnë qytetin duke e bombarduar rëndë atë, por kundërsulmi epik i republikanëve shënon një tjetër fitore për ta. Me gjithë fitoret e korrura, ushtria republikane është ende në pritje të ndihmave nga jashtë. "Shpresa", pjesa e tretë dhe e fundit e romanit është një

ndërthurje skenash fluturimi e shpëtimi rreth misionit heroik në Terruel. Ky mision do të vulosë fitoren e republikanëve në Guadalajara. Vdekja gjithashtu, një nga temat e parapëlqyera nga Malraux, është shpesh e pranishme në bisedat e personazheve, të cilat kthehen shumë shpejt në diskutime filozofike. Në këtë pjesë, ritmi i shkrimit përshpejtohet, kapitujt bëhen më të shkurtër dhe personazhet janë të zhytura në aksion. Për André Malraux ky libër duhet të ishte simbol i triumfit mbi tiraninë dhe vdekjen. "Shpresa" u publikua kur lufta e Spanjës nuk kishte mbaruar ende, ndaj pjesa e fundit e këtij romani është një thirrje që Malraux u bën demokracive ndërkombëtare. Malraux shoqëroi publikimin e librit me një sërë konferencash në SHBA për të mobilizuar ndihmën ndërkombëtare.

Shkrimtar dhe intelektual i angazhuar francez, André Malraux (1901-1976) ka përjetuar ngjarjet



madhore të shekullit të 20-të, duke lënë gjurmë në letërsinë bashkëkohore franceze. Si mbrojtës i flaktë i dinjitetit njerëzor, Malraux angazhohet drejtpërdrejt në luftën kundër fashizmit.

Malraux shkrimtar, filozof, por njëkohësisht edhe njeri i aksionit, falë krijimtarisë së tij artistike dhe angazhimit politik ka ditur të na dhurojë në periudha kyçe të historisë së njerëzimit, vepra që kanë korrur një sukses ndërkombëtar.

Dhe pikërisht për të vazhduar këtë udhëtim nëpër shekull, duke ndjekur gjurmët e Malraux, një vit pas botimit të romanit "Gjendja Njerëzore", Shtëpia Botuese TOENA i sjell lexuesit shqiptar një tjetër kryevepër të këtij shkrimtari, romanin "Shpresa". Libri është publikuar për herë të parë në Francë në vitin 1937 dhe flet për 8 muajt e parë të luftës civile në Spanjë (1936-1939), nga grushti i shtetit të gjeneralit Franko më 18 korrik 1936 deri në Betejën e Guadalajara-së në mars 1937, ku republikanët dolën fitimtarë.

Pra, mund të themi për "Shpresën", se ideologjikisht ndjek perspektivën e komunizmit të asaj kohe, i cili i jepte përparësi luftës, disiplinës, organizimit, duke përfshirë të gjitha sakrificat që nënkupton një zgjedhje e tillë. Por kjo ide ngjyrosset shumë nga elementët romaneskë, nga dialogët në të cilat anarkistët shtrojnë pyetjen mbi vlerat e një fitoreje të ngritur mbi sakrifikimin e "të qenit" për hir të "veprimit". Por ky roman është mbi të gjitha një vazhdimësi e mendimit metafizik, i cili është thelbësor në veprën e André Malraux. Përtej ideologjive, personazhet përjetojnë "Fatin njerëzor"; duke i bërë ata të vetëdijshëm mbi gjendjen e tyre, njeriu matet me diçka që e tejkalon atë, por ky veprim nuk e çon atë domosdoshmërisht drejt dështimit apo vdekjes. Por Malraux nuk ndalet me kaq, ai adapton romanin dhe realizon filmin me titullin "Sierra del Terruel", i cili u shfaq për herë të parë në vitin 1939. Ky film, edhe pse u ndalua gjatë Luftës së Dytë Botërore, u rishfaq sërish në vitin 1945 me titullin "Shpresa". Ai u kurorëzua gjithashtu me çmimin "Louis Delluc" (çmimi më i lartë i kinemasë franceze, të cilin e quajnë gjithashtu dhe çmimi Gorncourt i kinemasë).

\*Përkthyes